



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 486/ 2 prot

Datë 09.03.2022

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur - Mallra, me mjete elektronike”, me Nr. REF-07256-10-05-2021, me objekt: “Blerje Materiale Specifike për aplikimin e Kimioterapisë për Shërbimin Onkologjik, për një periudhë 12-Mujore” me fond limit 18.812.613,33 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.01.2022 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Euromed” SHPK  
Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Pall 298, H 16  
Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”  
Adresa: Rruga e Dibres Nr. 372, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Fedos” SHPK  
Adresa: Rruga “Manol Konomi”, Nd. 14, Ap. 2, Tiranë.

Në datën 08.03.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 486 e operatorit ekonomik “Euromed” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur - Mallra, me mjete elektronike”, me Nr. REF-07256-10-05-2021, me objekt: “Blerje Materiale Specifike për aplikimin e Kimioterapisë për Shërbimin Onkologjik, për një periudhë 12-Mujore”

me fond limit 18.812.613,33 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.01.2022 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “Euromed” SHPK, në ankesën me nr. 486 prot., datë 08.03.2022, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

## - KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*

### 2.3. Kapaciteti teknik:

*a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës se fondit limit\* dhe që është realizuar tre vitet e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autodeklarate për materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat 90/385/EEC ose 93/42/EEC ose Rregullores (EU) 2017/745, ose sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës 98/79 EC (të përditësuar), ose FDA , bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatëse CE/DC (Declarate konformiteti) ose Regjistrimit FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.*

ç) Për të gjithë artikujt e ofruar **te paraqiten katalogje**, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (***pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohehet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen***). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (***te markuara sipas artikullit***) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Gjithashtu ankimuesi pretendon se shoqëria “Fedos” SHPK nuk përmbush kërkesat e nenit 93, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi nuk ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 09.03.2022.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**